

Përgjigje e Kundërshtimit ndaj referatit për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Vizatim, Vizatim me pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës

Ankesa ndaj referatit për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Vizatim, Vizatim me pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës u shqyrtua me kujdes nga anëtarët e Komisionit recenzues në përbërje: prof. Reshat Ameti – kryetar, prof. Ilirjan Beqiri – anëtar dhe prof. Zenun Sherifi – anëtar dhe Komisioni në fjalë e jep këtë Përgjigje në formë të raportit tekstual:

1. Kandidati Mr. Verim Zendeli pretendon që Komisioni recenzues nuk e ka përpiluar siç duhet vlerësimin me pikë tabelare. Komisioni recenzues me përgjegjësinë më të plotë deklaroi që shtojca tabelare ndaj referatit për zgjedhje është përpiluar në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014.
2. Kandidati më pas pretendon që në referat nuk janë publikuar të gjitha të dhënat për veprimtarinë e tij.
Komisioni recenzues potencon që në referat është përmbledhur i gjithë dokumentacioni të cilin kandidati e ka dorëzuar në Konkurs.
3. Kandidati poashtu pretendon që pikët e fituara të kandidatit të propozuar për t'u zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore nuk janë të vlerësuara në mënyrë të rregullt.
Ne si Komisioni recenzues deklarojmë që vlerësimi i pikëve është në përputhshmëri të plotë me Kriteriumet për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje në thirrje mësimore dhe në pajtim të plotë Rregulloren për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore. Kandidatja e propozuar për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore Mr. Drenusha Palloshi e plotëson numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore docent.
4. Kandidati që ka parashtruar kundërshtimin nuk e plotëson kriterin themelor për zgjedhje në thirrje mësimore të paraparë me nenin 164 pika 3 të ligjit për arsimin e lartë sipas të cilit kandidati duhet të ketë rezultate dhe përvojë në veprimtarinë mësimore dhe përgatitje të kuadrit të ri mësimor

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dosjes së kandidates Mr. Drenusha Palloshi ka konstatuar se e njëjta që nga viti 2015 është e angazhuar me kontratë për shërbime intelektuale në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës dhe me sukses e ka kryer veprimtarinë e saj mësimore për lëndët mësimore Vizatim dhe me këtë ka përparësi ndaj kandidatit tjetër i cili nuk ka përvojë në ushtrimin e veprimtarisë mësimore dhe veprimtarisë së arsimit të lartë. Kandidatja Mr. Drenusha Palloshi ka të arritura në zbatimin e rezultateve hulumtuese dhe aftësi për kryerjen e llojeve të caktuara të veprimtarisë së arsimit të lartë.

PËRFUNDIM ME PROPOZIM

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, Komisioni recenzues konsideron që Kundërshtimi i kandidatit Mr. Verim Zendeli, është e pabazë. Komisioni recenzues në përbërje prof. Reshat Ameti – kryetar, prof. Ilirjan Beqiri – anëtar dhe prof. Zenun Sherifi – anëtar, ka nderin e veçantë që edhe njëherë Këshillit të Rektoratit t'i propozojë që kandidatja Mr. Drenusha Palloshi të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore docent për lëndët mësimore Vizatim, Vizatim me pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës.


Tetovë, 14.09.2018

Komisioni recenzues

Prof. Reshat Ameti



Prof. Ilirjan Beqiri



Prof. Zenun Sherifi

